

Pyetje dhe përgjigje për kartat biometrike të identitetit për të Huajt (NAA10)

- **Si mund të kuptoj, nëse është i nevojshëm inçizimi biometrik?**
Nëse është e nevojshëm, në Entin e Migracionit të Kantonit St Gallen, Ju do të merrni një termin për inçizimin e të dhënave biometrike.
- **Kush e merr një kartë të re biometrike për të Huajt?**
Vetëm shtetasit e vendeve të treta me leje qëndrimi L-, B- dhe C-. Shtetasit e vendeve të treta me leje qëndrimi F- ose N- nuk do të marrin kartën biometrike për të Huajt.
- **A mundet që termini i marrë të shtyhet - nëse po, si?**
Për arsye të rëndësishme shtyerja e terminit mund të bëhet direkt pranë zyrës për karta të identitetit në tel. 058 229 88 77 (Hënë - Premte prej orës 08:00-11:30 dhe 13:30-17:00).
- **Sa kushton dhe si mund të paguhet inçizimi biometrik?**
Harxhimet e inçizimit biometrik: CHF 20:00 për person (pagesë në dorë, EC/Postcard). Taksat për kartën e identitetit për të Huajt bëhen veçmas pranë Entit Komunal.
- **A mund pa termin ose direkt të paraqitem në sportelin e zyrës për karta të identitetit?**
Jo.
- **Cilët të dhëna inçizohen?**
Fytyra, gjurmët e dy gishtërinjëve dhe nënshkrimi.
- **Çfarë duhet të sjell unë me vete?**
Shkresën me termin, pasaportën tuaj, CHF 20 për person, dhe në rastin e dhënë kartën e vjetër të identitetit për të Huajt.
- **A mund të dorëzoj një kërkesë për kartë biometrike, edhe pse karta ime e tanishme është ende e vlefshme?**
Jo. Karta e deritashme e identitetit për të Huajt mbetet e vlefshme deri në datën e skadimit.
- **Ku gjindet zyra e pasaportave për inçizim biometrik?**
Oberer Graben 32, 9001 St Gallen
- **Si mund të marrë normalisht kartën time të re të identitetit për të Huajt?**
Karta e identitetit për të Huajt do të Ju dërgohet juve në shtëpi me postë të rekomanduar.
- **Ku mund të marrë informacione plotësuese?**
<http://www.migrationsamt.sg.ch> ose <http://www.ausweisstelle.sg.ch/>